

VENDIM
Nr.61, datë 19.8.2009

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “PURO ENERGY STEBLEVA” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 “a”, neni 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, neni 18 pika 1 germa “d” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, dhe 13, 14 të rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.8.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “PURO ENERGY STEBLEVA” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronesor (neni 9, pika 2);
- Dokumentacionin finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Dokumentacionin teknik (neni 9, pika 4);
- Lejet nga institucione të tjera (leja mjedisore dhe leja e përdorimit të ujit) (neni 9, pika

4.1.5, germa “b” dhe “c”)

Mungesa e Dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Plotësimin në mënyrë të pjesshme të lidhjes me sistemin elektroenergjetik (neni 9, pika 4.1.5, germa “a”, pasi për arsye të privatizimit dhe riorganizimit të shoqërisë OSSH sh.a., aplikuesi nuk ka mundur të paraqesë një dokument final nga OSSH sh.a. (është paraqitur vetëm nga drejtoria rajonale TL Elbasan)

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “PURE ENERGY STEBLEVA” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Stebleva me fuqi 3.4 MW me kusht që të paraqesë dokumentin e miratimit të pikës së lidhjes me sistemin elektroenergjetik para fillimit të operimit të HEC Stebleva.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

3. “PURE ENERGY STEBLEVA” shpk ta fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Stebleva sipas afatit të përcaktuar në marrëveshjen e koncesionit.

4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta